



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
REKTORATI

Nr. 2820 Prot.

Tiranë, më 30.10.2023

**NJOFTIM**

Universiteti i Sporteve të Tiranës, mbështetur në urdhrin nr. 374, datë 14.7. 2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, “Për hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën e psiko-pedagogjisë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, në Vendimin e Senatit Akademik nr.113, datë 16.10.2023 “Për emërtimin e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, sipas Urdhrit të MAS dhe miratimin e propozimit të tarifës së shkollimit për këtë program”, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.73, datë 17.10.2023 “Për emërtimin e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, sipas Urdhrit të MAS dhe miratimin e propozimit të tarifës së aplikimit, tarifës së rregjistrimit, tarifës së shkollimit për këtë program”, njofton se:

1. Në vitin akademik 2023-2024, në Departamentin e Edukimit dhe Shëndetit, të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes të Universitetit të Sporteve të Tiranës, fillon veprimtarinë akademike; **PROGRAMI I STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN E PSIKO-PEDAGOGJISË.**
2. Programi i studimit të formimit të vazhduar në fushën e psiko-pedagogjisë, organizohet si vijon:
  - Numri i krediteve (ECTS): 35
  - Koha e fillimit të programit: Semestri i II (dytë) i vitit akademik 2023/2024
  - Kohëzgjatja: 1 (një) semestër
  - Forma e studimit: Me kohë të plotë.
  - Gjuha e realizimit të programit: shqip
  - Në përfundim të programit të studimit, lëshohet Çertifikatë për formimin psiko-pedagogjik, referuar Nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
3. **Afati për aplikimin:** Procedurat e aplikimit për pranimin në programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën e psiko-pedagogjisë, janë të hapura për kandidatët prej datës 01.11.2023 e në vazhdim. Kandidatët fitues do të njoftohen për fillimin e procesit mësimor sapo të jetë krijuar numri minimal për formimin e grupit.

4. Kanë të drejtë të aplikojnë dhe të regjistrohen ata kandidatë që:
- kanë fituar diplomë të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor”
  - kanë fituar diplomë të programit të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” ose “Master profesional” me 120 kredite, apo ekuivalente me to në Fushën e Edukimit Fizik, Sport dhe Shëndet (sipas Udhëzimit nr. 3, datë 15.2.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve “Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlerëshme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhdueshëm në fushën e psiko-pedagogjisë”);
5. **Dokumente të aplikimit dhe forma e aplikimit:** Dosja e aplikimit të kandidatit do të përmbajë;
- 5.1 Kërkesën me shkrim të kandidatit për pranimin në programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën e psiko-pedagogjisë të Universitetit të Sportit të Tiranës.
- 5.2 Curriculum vitae, ku ndër të tjera të pasqyrohet informacioni për institucionet e arsimit të lartë ku kandidati ka fituar diplomat e përcaktuara në pikën 4 të këtij njoftimi si dhe mundësitë e kontaktit ( nr. telefoni dhe adresë e mail-i)
- 5.3 Kopje të noterizuara të diplomave të përcaktuara në pikën 4 të këtij njoftimi.
- 5.4 Mandat pagesën e tarifës së aplikimit. Fomulari i pagësës së tarifës (**kliko këtu**)
- 5.5 Dosja e aplikimit do të paraqitet në Sekretarinë Mësimore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
6. Vendimi për përzgjedhjen e kandidatëve për pranimin në programin e studimit të formimit të vazhduar në Fushën e Psiko-Pedagogjisë pranë Universitetit të Sporteve të Tiranës, do të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Sporteve të Tiranës, si dhe në adresën elektronike të kandidatit/ve.

**REKTORI**

**Prof.Dr. AGRON KASA**

